005/ 15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

VENDIM

Nr. 13, Datë 07.03.2014

PËR

MIRATIMIN E INSTRUMENTIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË KORÇË

Në mbështetje të neneve 8/1, pikat 1 dhe 3, dhe 27 të Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Pë Planifikimin e Territorit", i ndryshuar, Kreut III "Planifikimi Vendor" të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 "Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit" i ndryshuar, VKM-së nr 887, datë 03.10.2013 "Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit" me propozimin e Bashkisë Korçë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

2. Pjesë përbërëse e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor janë:

   a. Politika e Zhvillimit të Territorit,
   b. Plani i Përgjithshëm Vendor,
   c. Rregullorja Vendore e Planifikimit,
   d. Materiali grafik (harta).

3. Pjesa e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor që parashikon zhvillime në kategorinë "tokë bujqësore", sikurse evidentuar në materialin grafik përkatës, hyn në fuqi vetëm në rast se parashikimi është për zhvillime ekonomike dhe mbi të gjitha, vetëm pasi të realizohet konvertimi i kategorisë së resursit "tokë bujqësore" në kategorinë e resursit "tokë urbane" sipas legjislacionit sektorial në fuqi.

4. Ujesa e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor që parashikon ndryshimet e kufijve ekzistues të zonës së mbrojtur dhe qendrës historike duhet të garantojë në çdo rast ruajtjen e objekteve me vlera të veçanta të trashëgimisë arkitektonike dhe kulturore.

5. Ngarkohet Bashkia Korçë të kryejë bashkërendimin me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave në lidhje me zbatimin e pikës 3.

6. Ngarkohet Bashkia Korçë të kryejë bashkërendimin me Ministrinë Kulturës në lidhje me zbatimin e pikës 4, për klasifikimin e objekteve me vlera të veçanta të trashëgimisë arkitektonike dhe kulturore brenda zonës aktuale të mbrojtur dhe qendrës aktuale historike si edhe për ruajtjen e tyre në mënyrë që zhvillimet e reja të mos cënojnë këto vlera.

7. Ngarkohet Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT - KËSHILLI I MINISTRAVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 676 Prot. Datë 08.05.2014

Lënda: **Dërgohet Vendimi Nr. 13, datë 07.03.2014 i KKT**

1153
12.5.14

Drejtuar: **Z. Sotiraq Filo**
Kryetar,
Bashkia Korçë

I nderuar z. Filo,

Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 07.03.2014 ka marrë vendimin Nr. 13 **"Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë"** në përputhje me ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar.

Vendimi është sigluar nga Sekretarja e K.K.T-së, Zëvendës Kryetarja e K.K.T-së, si dhe nga Kryetari i K.K.T-së. Gjithashtu, dokumentacioni bashkëlidhur vendimit, përkatësisht Harta e Propozuar e Përdorimit të Tokës dhe Harta e Infrastrukturës Rrugore së Propozuar, janë sigluar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak Korçë, Kryetari i Bashkisë Korçë si dhe nga Kryetari i K.K.T-së.

Bashkëlidhur Ju lutem gjeni dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vendimi Nr. 13, i K.K.T-së, datë 07.03.2014;
- Harta e Propozuar e Përdorimit të Tokës;
- Harta e Infrastrukturës së Propozuar.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT AKPT AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

APP Rrezmi



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT

SEKRETARE E KKT

Znj. ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

009/15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
INSPEKTORIATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR

Adresa : Rr. "Muhamet Gjollesha", pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit – Tel. 22 39 33

Nr. 152/1 Prot.

Tiranë, më 25/02/2015

LENDA: Kthim përgjigje

DREJTUAR: **Av. Dorian Matlija**
Qendra " RES PUBLICA"
Adresa: Rr" Nikolla Tupe", pall.4, shk.1, ap.5, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj datë 07.01.2015, protokolluar pranë zyrës sonë me nr. 152 prot. datë 08.01.2015, në lidhje me punimet e kryera në zonën historike të sheshit të "Luftëtarit të Panjohur" në qendër të Korcës, lutemi të gjeni bashkangjitur dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj.

Ju urojmë ditë të mbarë

Dallëndyshe BICI
KRYEINSPEKTOR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT KORÇË
INSPEKTORIATI NDERTIMOR E URBANISTIK VENDOR

ADRESA: Ish shkolla Iopublike KAVALIOTI ,kati I II tel. 082252802

Nr 734/1 Prot. Korce me , 10 , 5 , 2012

Lenda : KTHIM PERGJIGJE

INSPEKTORIATIT NDERTIMOR URBANISTIK KOMBETAR

TIRANE

Per Dijeni: SHOQATA "QYTETARIA KORCARE"
BULEVARDI "SHEN GJERGJI

KORCE

Ne lidhje me tuajen nr.2001/1 prot. Dt. 02.05.2012, protokolluar me tonen nr.734 dt. 03.05.2012, shqetesimin qe ngre shoqata "Qytetaria Korcare" per punimet qe po kryhen per rikonstruksionon e rrugeve ne bul "Shen Gjergji" dhe sheshit para Katedrales, ju veme ne dijeni se keto punime po kryhen ne baze te lejes se ndertimit, miratuar me vendimin e KRrT-se se Bashkise Korce, nr. 17 dt. 21.05.2010.

Pretendimi qe ngre shoqata "Qytetaria Korcare" se ky bulevard eshte brenda zones se mbrojtur dhe si tille ky projekt duhej miratuar edhe ne instancat qe jane pergjegjese per kulturen kombetare, bazohet ne V.K.M. Nr. 238 date 23.03.2011, e cila ka hyre ne fuqi pas dates se miratimit te lejes se ndertimit dhe nuk ka efekte prapavepruese.

Ne daten e miratimit te lejes se ndertimit, ky bulevard nuk ka qene pjese e zones se mbrojtur, pra ka qene teresisht kompetenca e KRrT-se se Bashkise Korce te miratonte lejen e ndertimit per rikonstruksionin e tij.

Faleminderit per mirekuptimin.

KRYETARI I BASHKISE KORCE

Niko PELESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
INSPEKTORIATI NDËRTIMOR URBANISTIK KOMBËTAR
Drejtoria e Inspektimit Juridik

Adresa "Bv. Mahmut Gjallesha" prane fakultetit te Informatikes se Ndertimit - Tel: 22 37 33

Nr. 2001 Prot. Tiranë, më 20.04.2012

L Ë N D A : Zbatim ligjshmerie

D R E J T U A R : INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK

BASHKIA KORCE

PER DIJENI: INSPEKTORIATI NDERTIMOR URBANISTIK KOMBETAR

DEGA KORCE

SHOQATA "QYTETARIA KORCARE", BULEVARDI " SHEN GJERGJI"

KORCE

Me shkresen nr. 2001 Prot, date 20.04.2012 shoqata " Qytetaria Korcare" ngre pretendimin lidhur me punimet "Rikonstruksion i sheshit para Katedrales" te shpalluara me tender nga Bashkia Korce. Sipas ankuesit nga Bashkia Korce nuk eshte marr leje nga Keshillimi Kombetar i Restaurimit per keto punime, duke qene se kjo zone eshte shpallur qender historike.
Sa me siper, te verifikohet situatuata ndertimore ne vend dhe ne rast konstatim kundravajtje te fillojne procedurat e menjehershme ligjore.
Ne perfundim bazuar ne nenin 5/e te ligjit nr. 9780 date 16.07.2007 " Per inspektimin e ndertimit", i ndryshuar, te informohet INUK dhe ankuesi.
(bashkengjitur nje kopje e ankeses)

KRYEINSPEKTORI

Gazmend OSMANI

SHOQATA "QYTETARIA KORÇARE"
Adresa: Qëndra "Baze", Bul "Shën Gjergji" Korçë
Përfaqësuesi ligjor cel.: 0694113575

Nr. ____ _ Prot. Korcë, më 16.04.2012

Lënda : Ndërtimet në zonën historike të sheshit të "Luftëtarit të Panjohur", në qëndër të Korcës

Drejtuar: MINISTRIT TË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE TIRANË

Për dijeni: INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR URBANISTIK KOMBËTAR TIRANË

I nderuar Z. Ministër,

Shoqata "Qytetaria Korcare", e themeluar me qëllim akumulimin, inkurajimin, orientimin dhe përhapjen e mendimit intelektual në shërbim të qytetit te Korcës dhe të komunitetit qytetar korcar, e regjistruar si organizatë jofitimprurëse me Vendimin Nr. 3278, datë 19.03.2012, të Gjykatës të Tiranës, ju paraqet kërkesën e mëposhtme:

Në Buletinin e Prokurimit Publik të datës 26.03.2011, Bashkia e Korcës ka shpallur tenderin për "Rikonstruksionin e sheshit para Katedrales". Ky rikonstruksion konsiston në ndryshimin e përmasave të Bulevardit dhe të trotuarëve në sheshin ku ndodhet përmendorja e simbolit të Korcës, "Luftëtarit të Panjohur". Kjo qëndër, me VKM Nr.238, datë 23.03.2012, është shpallur qëndër historike. Bashkia e Korcës duhet që paraprakisht të kishte marë nje lejë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Për njohuritë tona nuk ka marë lejë, pra po veprôn në shkelje të Ligjit. Më poshtë po ju japim të detajuar në menyrë kronologjike një sërë faktesh lidhur me këtë qëndër:

1. Në mesin e vitit 2009 shpallet tenderi ndërkombëtar për masterplanin e qëndrës të Korcës. Tendri fitohet nga firma Bolles & Willson. Në Dhjetor të vitit 2009 firma fituese paraqet një planimetri të masterplanit të qëndrës, (fotokopje bashkëngjitur) ku ngushtohen të gjitha sheshet në qëndër të Korcës. hiqen parkinget, ngushtohen bulevardet, dhe në sipërfaqet e përfituara, rreth 3000 m^2 pronë publike zihet me ndërtime. Bazuar në ligjin "Për planifikimin e teritorit" plani duhet te miratohej ne Këshillin Kombëtar të Teritorit.

2. Për ti shpëtuar detyrimit ligjor të mësipërm, Bashkia shkëput nga masterplani i qëndrës pjesën e infrastrukturës rrugore (fotokopja bashkëngjitur) dhe e paraqet në KRT-në e Korcës si plan për rikonstruksionin e bulevardit, të projektuar nga firma shqiptare "TEC Konsult". Në fakt nuk kemi të bëjmë me një rikonstruksion përderisa ndyshojnë të gjitha përmasat e bulevardeve dhe të trotuareve. Leja e ndërtimit për rikonstruksionin miratohet nga KRT Korcë në Maj 2010.

3. Mbas muajit Maj 2010, bëhen disa tentativa për të kaluar masterplanin e qëndrës në KRT Korcë, por plani nuk miratohet nga KRT. Sidoqoftë mbetet në fuqi vendimi i rikonstruksionit të rrugeve, që është një zbatim pjesor i mastreplanit të pamiratuar ligjërisht. Rikonstruksioni fillon të zbatohet në

sheshin para Kinemase. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar pezullon punimet dhe me Vendimin Nr. 4, datë 10.11.2010 (fotokopja bashkëngjitur) vendos prishjen e punimeve dhe kthimin në gjëndjen fillestare. Ndërtimet pa leje u prishën, por bulevardi nuk u kthye në gjëndjen fillestare.

4. Mbas zgjedhjeve të qershorit 2011, filluan punimet në sheshin para kinemasë. Nuk dimë në dijeni të faktit në se Inspektoriati Kombëtar nderhyri apo jo, por ndërtimi u kry. Masterplani i qëndrës, ndonse i panmiratuar, filloi të zbatohej në formë rikonstruksioni.

5. VKM 238, datë 23.03.2011, "Për shpalljen e qëndrës historike të qytetit të Korcës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj" shpall pjesë të qëndrës historike ansamblin mbi përmendoren e "Luftëtarit të Panjohur".

6. Në kundërshtim me këtë VKM, përmendorja spostohet disa muaj mbas daljes të VKM 328, gjithmonë në zbatim të masterpalanit. Gjithashtu përmendorja gjymtohet, duke i hequr zinxhirët rrethues që i kishte vendosur autori (Odhise Paskali). Ndryshojnë gjithashtu dhe përmasat e bulevardit në këtë shesh. Paraprakisht për këto ndryshime, bazuar ne ligjin "Për trashëgiminë kulturore" duhet të ishte marë lejë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit. Një lejë e tillë nuk është marë në dijeninë tonë.

7. Kanë filluar tratativat për të gjetur financim për bulevardin "Shën Gjergji", ndërsa trotuari i ndryshuar para Katedrales është tenderuar dhe pritet të fillojnë punimet, menjëherë mbas shpalljes të fituesit. Pra masterplani i qëndrës, ndonse i pa miratuar, po zbatohet pjesë-pjesë, si rikonstruksion, duke ngritur sheshet e ndërtimit për shumëkatëshet, që do të ndërtohen në të ardhmen, kur të gjendet mbështetja e nevojshme në KKT. Bashkëngjitur po ju dërgojmë disa fotokopje të masterplanit, për tu njohur me dëmin që ky plan i bën qëndrës te Korcës.

I nderuar zoti Ministër! Qëndra e Korcës po dëmtohët në mënyrë të pariparueshme dhe po vazhdoi kështu, së shpejti do te privatizohet, për të mbushur xhepat e një grupimi njerëzish, në dëm të gjithë qytetarëve të Korcës. Lutemi, që në funksionin tuaj si Kryetar i Këshillit Kombëtar të Restaurimit, të ndërhyni për të ruajtur zonën historike, për të ndaluar ngushtimin e sheshit të "Luftëtarit të Panjohur" dhe për kthimin e përmendores në vendin dhe formën origjinale. Cdo ditë vonesë është me pasoja për qytetin.

PËRFAQESUESI I SHOQATËS

SOTIRAQ STRATOBËRDHA



...A E SHQIPERISE
...E PUNEVE PUBLIKE
...PORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
...KTORIATI NDERTIMOR E URBANISTIK KOMBETAR

№ 003079

VENDIM
PER PRISHJEN E OBJEKTIT

Nr. 04, Datë 20/11/2009

Në bazë te Proçes-Verbalit Nr. —, Datë 02/11/2009 me nr.serie AQ3774 të mbajtur nga inspektori / inspektorët e Inspektoriatit Ndërtimor e Urbanistike Kombëtar B. Jellaci, E Beja, A Peta, G Hysi në subjektin Juridik/fizik Ndermarrja e Gjelberimit, Bashkia ..., ka rezultuar se është kryer kundërvajtja kryen punime pa lejen e ndertimit ne shperndarje te objekti i vet, Bulevardi Republika, pa dokumentacion teknik lejon ndertimin, parashikuar në nenin/et 75 e ligjit Nr. 8405, datë 17/09/98 "Për Urbanistiken"

PER KETO ARSYE

Bazuar në nenin/et 9/a, të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, Për inspektimin e ndërtimit" dhe në nenin/et 75, të ligjit Nr. 8405, datë 17/09/98. "Për Urbanistiken".

VENDOSA:

Dënimin për prishje të objektit Ktheu ne gjendjen e meparshme
Ndaj kundërvajtësit Ndermarrja e Gjelberimit, Bashkia Vlore
Me adrese Segmenti Rruga "Milenium" - Qyteti Vlorës, Bulevardi Republika

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i drejtpërdrejt në gjykatë, brenda 10 ditëve duke filluar nga data e njoftimit te vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi nuk pezullon ekzekutimin e tij.

KRYEINSPEKTORI
Gjergj Rajnxhi